

K.nr.7384/2012

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE,
Gjyqtarja Lirije Kafexholli me sek.juridike Belkize Gashi në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Xhelal Rrahman Qelaj nga fsh. Grejkoc, për shkak të vepres kundërvajtëse nga neni 5 dhe 6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për deklarimin, prejadhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të lartë publik, e në bazë të nenit 73,195 dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datë, 22.10.2013 merrë këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI : Xhelal Rrahman Qelaj I lindur me dt. 26.03.1962 në fsh. Grejkoc Komuna e Suharekës, ku dhe tani jeton, i martuar i ati I dy fëmijë, ka të kryer fakultetin ekonomik, gjerë me tani kinse jo i denuar.

ËSHTË PËRGJEGJES

Sepse si Zyrtar i lartë publik - Këshilltar Komunal - Suharekë nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë së tij për vitin 2011 deri me 31.03.2012 në Agjencionin Kundër Korrupsionit në Prishtinë

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 5 dh 6 par. 1..3 dhe neni 9 të Ligjit nr.04/L-050 për deklarimin prejadhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të zyrtareve të lartë publik dhe deklarimin, prejadhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar e me aplikimin e të njëjtit:

GJOBITET

Me gjobë në të holla në shumë prej 400 (katëqindë) EURO të cilin ka për ta paguar brenda 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktvendimi në favor të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me nr.gjirollg.1000-4300-7000-0518, pagesa bëhet nëpërmes të kësaj Gjykate.

Nese denimin e caktuar nuk e paguan në afatin e caktuar i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh duke iu llogaritur nga 20 EURO. qdo ditë burgimi.

Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse shuma paushalle prej 10 EURO, i paguan i pandehuri në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merrë formën e prerë në favor të Gjykates Themelore Prizren - Dega në Suharekë – Divizioni për Kundërvajtje.

Me nga një ekzemplar të këtij aktvendimi të njoftohen palet.

ARSYETIM

Me kërkesen e Agjencionit Kundër Korrupsionit në Prishtinë me nr. 01/2510/12 të dt. 13.07.2012 është ngritur procedura kundërvajtëse, kundër të pandehurit me motivacion se ka kryer kundërvajtjen nga neni 17 par.1.3 të Ligjit për deklarimin, prejadhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejadhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar

Gjykata mori në pyetje të pandehurin Xhelal Qelaj I cili ka pranuar kundërvajtjen me të cilën është i ngarkuar duke deklaruar: se është e vertet se nuk e kam bërë deklarimin e pasurisë prej dt 01. deri me 31 mars 2012 për vitin 2011 pranë AKK në Prishtinë nga arsya se nuk kame qenë i informuar nga personat e autorizuar Sa I perket deklarates se dëshmitarit I cili ka deklaruar se e kame pranuar njoftimin dhe formularin e AKK nuk është e vertet sepse po ti kisha pranuar do ta kisha deklaruar pasurinë, ndërsa nënshkrimi I cili është në fletëdorëzimin e pranimit të materialit nuk është i imi. deklarimin e pasurisë e kame bërë për vitin 2012 poashtu edhe për vitet tjera ndërsa për vitin 2011 nuk e kam bërë, meqenëse nuk e kam bërë shtimin e pasurisë kam menduar se nuk kame obligim që ta bëjë deklarimin e pasurisë, gjykates I propozoj që ti merrë si rrethana lehtësuese me rastin e shqiptimit të denimit.

Gjykata për vertetimin e gjendjes faktike muar në pyetje dëshmitarin Ragip Sadikaj I cili ka deklaruar punoj në Kuvendin Komunal në Suharekë në Drejtorin për ekonomin dhe financa në vendin e punës zyrtar për menagjimin e pasurisë, jame I caktuar nga Kryetari I Komunes së Suharekës si zyrtar I pikës kontaktuese në mes të Komunes së Suharekës dhe AKK –së -Prishtinë. Sa I perket lëndës e cila është e ngritur kundër Xhelal Qelaj nga fsh. Grejkoc për mos deklarim të pasurisë deklaroi se materialin e nevojshëm se bashku me formularin e AKK-së – Prishtinë dhe njoftimin ia kam dhënë shpërndarës të postës (punëtorit të Kuvendit të Komunes) Fatmir Kices që t'a dorzoi këtij personit. I cili me ka njoftuar se ia ka dorzuar vet personit në fjalë, gjykates si prove ia prezenton fletëdorëzimin e dt. 02.03.2012 mbi pranimin e njoftimit mbi deklarimin e pasurisë të cilën e ka pranuar vetë Këshilltari Komunal – Xhelal Qelaj nga fsh. Grejkoc.

Gjykata muar në pyetje edhe dëshmitarin Florim Kicaj I cili ka deklaruar: punoj në Kuvendin Komunal në Suharekë shpërndarës postal, me dt. 02.03.2012 personi kontaktues Ragip Sadikaj me ka obliguar që njoftimin si dhe formularin mbi deklarimin e pasurisë të ia dërgoj Këshilltarit Komunal Xhelal Qelaj ku të njëjtit ia kame dhënë të njëjten ditë në oborrin e Kuvendit Komunal të Suharekës I cili e ka nënshkruar fletëdorëzimin mbi pranimin e njoftimit dhe formularit të AKK –së – Prishtinë.

Në cilësinë e dëshmitarit u ftua përfaqësuesi I AKK- – Prishtinë – Agron Behrami I cili ka deklaruar : se në hyrje në fuqi të Ligjit të ri për deklarimin, prejadhjen e pasurisë 04/L-050 për obligim kanë edhe Këshilltarët Komunal të bëjnë deklarimin, prejadhjen e pasurisë gjatë muajit Mars të qdo

viti kalendarik .AKK kanë filluar pregaditjet per deklarimin e rregullt vjetor te pasuris si dhe deklarimin sipas kerkeses se agjencis per zyrtar te lartë publikë te cilet nuk kane patur me heret obligim per deklarimin e pasurisë , njoftimet I kemi shperndarë te gjithë zyrtarve kontaktus neper institucione, zyrtart kontaktues kanë per obligim ti njoftojnë zyrtaret e lartë publik me pajtim te nenit 4 te Ligjit te lartë permendur . AKK ka kontrolluar listat e zyrtarve te larte pbulik dhe ka konstatuar se zyrtari I larte publik Xhelal Qelaj nuk ka paraqitur deklarimin e pasurisë sipas kerkeses se AKK –së, andaj kemi paraqitur kerkese per iniciimin e procedures kundervajtese ndaj tij per kundervajtje nga neni 5 dhe 6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 dhe qe denohet konform nenit 17 paragrafi 1.3 te ligjit te lartpermendur , I njeiti nuk ka bërë deklarimin e pasuris prej 1 deri me 31 mars 2012 per vitin paraprak-2011 pranë AKK – në Prishtinë. AKK ka shperndar njoftimet edhe përmes email-it si dhe e ka publikuar ne web faqe te ajgencis se AKK.

Gjykata pas vlersimit të të gjitha provave në shqyrtimin kryesor: deklarates se te pandehurit, dhe deklaratat e dëshmitarve dhe pas vlersimit të të gjitha shkresave të cilat gjenden ne lëndë, konstatoj se i pandehuri ka kryer kundërvajtje si qe është e cekur ne dispozitiv te ketij aktvendimi andaj Gjykata per një veprim te tillë të pandehurin e shpalli përgjegjës mirëpo konform neni 9 te Ligjit mbi kundervajtjet ia zbuti denimin dhe ia shqiptoj denimin në të holla në shumë prej 400 EURO me bindje se do te ketë efekt pozitiv tek I pandehuri.

Gjykata me rastin e shqiptimit të denimit pati parasysh të gjitha rrethanat rënduse dhe lehtësuse të cilat ndikojnë në marrjen e Aktvendimit dhe se mendon edhe me këtë denim do të arrihet qellimi i denimit dhe do të ndikoj pozitivisht tek i pandehuri që në të ardhmën të mos përsëris kundërvajtje të natyres së tillë, Si rrethanë lehtësuese gjykata mori parasysh se I pandehuri per here te pare ka kryer keso lloj kundervajtje,, ndersa si rrethanë rënduese gjykata muar peshen e kundervajtjes se kryer.

Me sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të ketij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA E SUHAREKË – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE

Sek.juridike
Belkize Gashi

Gjyqtarja
Lirije Kafexholli

UDHEZIME JURIDIKE: Kundër ketij Aktvendimi kanë të drejtë ankese i pandehuri dhe parashtresi i kërkeses, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Divizionit për Kundërvajtje, në afat prej 8 ditësh, pas marrjes se ketij Aktvendimi nepermes kesaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Emri: DPK/DMP	Nr. Prot. 03-3773/13
Drejtori: DPK/DMP	Br. Prot. Prot. No.
Nr. Llog. 02	Data 07.11.2013
Nr. Postës	Date
PRISTINE	